



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 12,14 dhe 17 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 9 shkronja c), 17 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, dhe shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr.0204-1865/6 të dt.25.01.2016, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 03. 03. 2016, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Komunës miratojë këtë:

VENDIM

PËR ANULIMIN E VENDIMIT 1NR.464-331 DT.23.10.2003 DHE SHKËPUTJEN E KONTRATËS 1-463-322 DT.04.10.2007 PËR SHFRYTËZIMIN AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME

Neni 1

ANULOHEK Vendimi 1Nr.464-331 dt.23.10.2003 i Kuvendit Komunal Lipjan për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të tokës në pronësi të Komunës së Lipjanit dhe SHKËPUTET Kontrata 1-463-322 dt.04.10.2007 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh të pronës së paluajtshme P-71409036-00166-3 në vendin e quajtur "Branesh" me sipërfaqe prej 4300m² dhe P-71409036-00164-10 në vendin e quajtur "Branjesh" me sipërfaqe prej 45700m² të evidentuara në Certifikatën nr.4238/2015 ZK Konjuh, P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan shfrytëzues Qendra Medicinale "Intermed" Sh.P.K, e lidhur në bazë të Vendimit 1Nr.464-331 dt.23.10.2003, ndërmjet komunës së Lipjanit e përfaqësuar nga ish Kryetari i Komunës Xhevat Olluri (në tekstin e mëtejme-Komuna) si dhënës i tokës ndërtimore në shfrytëzim afatgjatë dhe shfrytëzuesit të tokës ndërtimore Qendra Medicinale "Intermed" Sh.P.K Lipjan përfaqësuar nga Dr.Fatmir Dalladaku (në tekstin e mëtejme-investitori).

Neni 2

Anulimi i Vendimit 1Nr.464-331 dt.23.10.2003 i Kuvendit Komunal Lipjan dhe shkëputja e Kontratës 1Nr.464-322 dt.04.10.2007 në bazë të nenit 10 par.10.1 dhe par.10.3 bëhet për arsye se shfrytëzuesi i tokës ndërtimore Qendra Medicinale "Intermed" Sh.P.K Lipjan nuk e ka përmbushur detyrimin kryesor për ndërtimin dhe funksionalizimin e Qendrës Medicinale "Intermed" të përcaktuar në nenin 5 par.5.2 dhe par.5.3 të Kontratës dhe nenit 3 të Marrëveshjes së Mirëkuptimit 1-350-9006 të dt.03.08.2012, dhe bazuar në nenin 11.par.11.4 Investitorit të cilit i shkëputet kontrata Komuna nuk ia kthen pagesën e taksave sipas nenit 4 par 4.4 dhe par 4.5 të kontratës.

Neni 3

Me këtë Vendim obligohet shfrytëzuesi i tokës ndërtimore Qendra Medicinale "Intermed" Sh.P.K Lipjan që në bazë detyrimeve kontraktore të cekura në par.11.3 të nenit 11 të kontratës 1-464-322 të dt.04.10.2007 që në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh kalendarike nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi të kthen ngastrat kadastrale në gjendjen e mëparshme.

Neni 4

Obligohet DGJK-Sektori për gjeodezi dhe kadastrë që të ndërmerr të gjitha veprimet procedurale për ndryshimin-marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të ngastrave kadastrale P-71409036-00166-3 në vendin e quajtur "Branesh" me sipërfaqe prej 4300m² ZK Konjuh dhe P-71409036-00164-10 në vendin e quajtur "Branjesh" me sipërfaqe prej 45700m² ZK Konjuh nga Qendra Medicinale "Intermed" Sh.P.K, dhe kthimin e tyre në librat publike P.SH KUVENDI KOMUNAL LIPJAN (siq ka qenë para dhënies së tokës në shfrytëzim).

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso- juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastrë, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati i Prokurimit dhe Drejtorati për Inspektion.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

Neni 7

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi anulohet Vendimi 15Nr.464-61551 dt.21.12.2015 i Kuvendit të Komunës së Lipjanit për shkëputjen e kontratës 1nr.463-322 të dt.04.10.2007 e lidhur ndërmjet komunës së Lipjanit dhe shfrytëzuesit të tokës ndërtimore Qendra Medicinale "Intermed" Sh.p.k Lipjan.

15Nr. 464-11830
Lipjan, më 04. 03. 2016

KUVENDI I KOMUNËS SË LIPJAN

KRYESUESJA E KUVENDIT
Vlora Limani-Hajrini

